

VENDIM
Nr. 543, datë 25.7.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
PUNËVE TË JASHTME, SI KONTRIBUT PËR SHOQATËN “ALBANIAN-AMERICAN
ASSOCIATION OF CLEVELAND”, PËR REALIZIMIN E MONUMENTIT TË NËNË TEREZËS
DHE NDËRTIMIN E PARKUT KOMBËTAR SHQIPTAR “NËNË TEREZA”, NË KLEVELAND,
OHIO, SHBA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, t’i shtohet fondi i përgjithshëm prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, si kontribut për shoqatën “Albanian-American Association of Cleveland”, e cila do të realizojë monumentin e “Nënë Terezës”, si dhe ndërtimin e Parkut Kombëtar Shqiptar “Nënë Tereza”, në Kleveland, Ohio, SHBA.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha